



ZYRA E KRYETARIT
KANCELARIJA PRESEDNIKA / MAYOR'S OFFICE / BASKAN OFISI

Në mbështetje të nenit 13 të Ligjit nr.03. L-040 për Vetëqeverisjen Lokale (LVL), neni 9, pika 1.6 të Statutit të Komunës së Gjilanit 01-126211 dt.06.11.2014, me ndryshimet dhe plotësimet në Statutin , 01. nr.016-28448 të dt. 22.03.2018, duke e parë gjendjen e rëndë ekonomike të viktimës së dhunës seksuale të znj. Shyrete Tahiri nga Gjilani dhe nevojën për strehimin e saj, dhe duke u bazuar në kërkesën 08.nr.343/04-73095/25 të datës :13.08.2025, Kryetari i Komunës nxjerr këtë:

VENDIM

PËR DHËNIEN NË SHFRYTËZIM TË PËKOSHËM TË BANESËS-PRONË KOMUNALE

Neni 1

Me këtë vendim I JEPET në shfrytëzim të përkohshëm prona komunale sipas njësisë 0-70403013-03532-0-214-0-19-0, Banesë 4 dhoma me sipërfaqe prej 113 m², e cila gjendet në ndërtesën e ish Kadastrit rr."A.Tahiri", në Gjilan, znj. Shyrete Tahiri me gjendje të rëndë ekonomike, sociale dhe shëndetësore, për plotësimin e nevojës urgjente të strehimit të saj.

Neni 2

2.1.Kohëzgjatja e shfrytëzimit të pronës komunale sipas nenit 1 të këtij vendimi nga shfrytëzuesja, do të jetë e përkohshme nga data 01.09.2025 deri më 01.02.2026/ 6 muaj.

2.2. Pas skadimit të këtij afati, shfrytëzuesja është e obliguar ta dorëzojë banesën në gjendje të rregullt, sikur kur e ka pranuar.

Neni 3

Shfrytëzuesja, nuk mund t'ia kalojë të drejtat dhe obligimet që rrjedhin nga ky vendim në persona të tretë.

Neni 4

Shfrytëzuesja është përgjegjëse për mirëmbajtjen dhe kujdesin nga dëmtimet eventuale të objektit banesor dhe kryerjen e obligimeve ndaj shërbimeve të komunalisë (shpenzimeve të rrymës, ujit, mbeturinave).

Neni 5

Për realizimin e këtij vendimi kujdeset Kryetari i Komunës, kurse zbatimin e tij e bënë Drejtoria e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale dhe Drejtoria e Shërbimeve Publike, Infrastrukturë dhe Banim.

Neni 6

Ky vendim është i plotfuqishëm me aktin e nënshkrimit nga Kryetari i Komunës.

Kryetari i Komunës
Alban Hyseni

Kopje:

-Palës:

-Drejtoria për Shërbime Publike, Infrastrukturë dhe Banim;

-Drejtoria e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale;

-Arkivës